

# KONTRATË THEMELIMI

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "PAOLA" shpk.



Me anën e këtij akti themelimi unë ortaku i vetëm i shoqërisë  
1. Apostol Hasan Paja

### VENDOSA

Të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të ket emërtimin  
e saj "PAOLA" shpk

### NENI 1

#### Emërtimi i shoqërisë

Shoqëria do të ket emrin e saj tregtar "PAOLA" shpk

### NENI 2

#### Forma juridike

Shoqëria "PAOLA" shpk, do të ket formën juridike të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria është person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare. Ajo zhvillon veprimtarinë e vet në përputhje me legjislacionin shqiptar, dispozitat e statutit dhe të Aktit të Themelimit.

### NENI 3

#### Vula e shoqërisë

Shoqëria do të ket vulën e saj përmbajtja e së cilës do të jet si vijon:  
"PAOLA" shpk

Në të gjitha aktet ose dokumentat që do të nxjerr shoqëria, shënohet emri i plotë i shoqërisë ose i shkurtuar, vlera e kapitalit themeltar dhe administratori.

### NENI 4

#### Selia e shoqërisë

Selia qendrore e shoqërisë është në Marinës, Belshë  
Ndryshimi i qendrës së selisë bëhet me vendim të ortakut të vetëm.

## **NENI 5**

### **Objekti i shoqërisë**

Pikë karburanti, lavazh, tregtim i mallrave të ndryshme me shumicë dhe pakic, ushqimore dhe industriale.

## **NENI 6**

### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi dhjetë vjet.

## **NENI 7**

### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mij) lekë.  
Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet me kontributete në natyrë.  
Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të ortakut.

## **NENI 8**

### **Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë janë

Ortaku i vetëm

Administratori

Administratori i shoqërisë është Apostol Paja.

## **NENI 9**

### **Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

Marrdhëniet në shoqëri rregullohen me dispozitat e Aktit të Themelimit, dhe statutit. Vendimet e administratorit në çdo moment duhet të jenë në përputhje me ligjin. Për çështje që nuk janë parashikuar në Statut dhe Aktin e Themelimit do të zbatohet legjislacioni në fuqi.

Kjo kontrat themelimi është hartuar në tre kopje me vlerë të barabartë në gjuhën shqipe. Për regjistrimin e shoqërisë përdoret një kopje e cila ka përparsi ligjore, Për sa më sipër unë ortaku i vetëm rashë dakort dhe nënshkruaj.

## **ORTAKU I SHOQËRISË**

Apostol Paja





**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“PAOLA” shpk**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “PAOLA” shpk ( e cila këtu e më poshtë do të njihet si “SHOQËRIA”), është themeluar në bazë të aktit të themelimit 10.01. 2003 nga z.Apostol Paja, që këtej e tutje do të njihet si ortak i vetëm. Kjo shoqëri në përputhje me legjislacionin shqiptar, me ligjin nr. 7638 datë 19.11. 1992, “Për shoqëritë tregtare”, krijohet nga ortaku i vetëm i kësaj shoqërie për të ushtruar veprimtari të ndryshme sipas parashikimeve të bëra në Aktin e Themelimit dhe në këtë Statut.

**Kapitulli 1**

**Dispozita të Përgjithshme**

**NENI 1**

**Forma e shoqërisë**

Shoqëria ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e cila themelohet nga një ortak i vetëm që përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në Kapitalin Themeltar.

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga ky statut, nga dispozitat përkatëse të ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 “ Për shoqëritë tregtare” si dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria do të filloi të veproi si person juridik që nga dita e rregjistrimit të saj në regjistrin tregtar të Shoqërive Tregtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ndërsa veprimtaria ekonomike fillon me rregjistrimin në organet tatimore.

**NENI 2**

**Emërtimi i shoqërisë**

Emërtimi i shoqërisë është “PAOLA” shpk

Në të gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet menjëherë me inicialet “SHPK”.

**NENI 3**

**Selia e shoqërisë**

Selia e shoqëri së është në fshatin Marinës, Belshë. Ajo mund të transferohet në çdo vend tjetër me vendim të administratorit. Shoqëria mund të hap degë dhe filiale të tjera edhe në qytetet e Shqipërisë.



#### **NENI 4**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi dhjetë vjet

#### **NENI 5**

#### **Objekti i shoqërisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është

Pikë karburanti me pakicë, lavazh, servisë, tregtim i mal; lrtave të ndryshme me pakicë.

#### **NENI 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mij) lekë, vënë nga një ortak i vetëm. Kapitali fillestar i shoqërisë mund të zmadhohet edhe me kontributet në natyrë, Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të ortakut të vetëm.

#### **Kapituli II**

#### **Administrimi i shoqërisë**

#### **NENI 7**

#### **Arganet drejtuese të shoqërisë janë:**

Ortaku i vetëm

Administratori

Administratori i shoqërisë është Apostol Paja

#### **NENI 8**

#### **Të drejtat e ortakut të vetëm**

Ortaku i vetëm i shoqërisë ka të drejtë të endos për bilancin vjetor, ndryshimet në statut, emërimin e ekspertit kontabël, mbylljen e aktivitetit të shoqërisë. Firma e ortakut është e domosdoshme për çështjet e mëposhtme.

Ndryshime në statut

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit fillestar

Ratifikimi i programit vjetor të aktivitetit të shoqërisë

Kohështrirjene aktivitetit të shoqërisë.

## NENI 9

### Kompetenca të tjera të ortakut të vetëm

Ortakut i vetëm merr vendime për çdo aspekt të veprimtarisë së shoqërisë.

Për sa kohë që shoqëria do të përbëhet nga një ortak i vetëm kompetencat e saj do të jenë:

Vendos për ndryshime në statutin e shoqërisë dhe miraton rregulloret për sektorët e veçant të saj.

Shqyrton bilancin vjetor, kuotat e fondeve të ndryshme dhe fitimin e realizuar.

Vendos për krijimin e filialeve, degëve ose përfaqësive të shoqërisë si dhe për krijimin e shoqërive të përbashkëta.

Vendos për marrjen e kredive si dhe për mbarimi e aktivitetit të shoqërisë, nëse në dokumentacionet financiare, rezultatet e shoqërisë vlerësohen në humbje.

Realizon marrdhëniet më të rëndësishme financiare dhe ekonomiketë shoqërisë me persona të tjerë juridik dhe fizik.

## NENI 10

### Administratori i shoqërisë

Administratori i shoqërisë administron aktivitetin operativ të shoqërisë.

Ai drejton shoqërinë për këto probleme:

Organizon punën për plotësimin e planit të shoqërisë

Në përputhje me planet dhe programet e përgjithshme kryen administrimin e shoqërisë, duke përfshirë dhe mjetet financiare.

Përfaqëson shoqërinë ndaj personave të tretë në gjykatë dhe arbitrazh, nënshkruan marrveshje në emër dhe për llogari të shoqërisë dhe siguron zbatimin e tyre.

Merr të gjitha vendimet lidhur me këto aktivitete

## Kapitulli III

### NENI 11

Financat, bilanci dhe veprimet financiare të shoqërisë



Veprimet financiare të shoqërisë pasqyrohen në librat financiar të shoqërisë (kontabilitetin) duke aplikuar kriteret dhe dispozitat e parashikuara nga legjislati shqiptar për kontabiliteti e shoqërive tregtare.

Shoqëria disponon dhe gëzon pasuritë e saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e themelimit të saj.

Shoqëria ka të drejtën e parablerjes dhe administrimit të pasurive të çdo lloji e natyre si dhe të jap vendim unanimit.

Shoqëria për sigurimin e aktivitetit të saj krijon fondet e saj. Përbërja, madhësia, burimet ekrijimit, përdorimi i rregullit i çdo fondi të veçant vendoset me vendim të ortakut të vetëm duke respektuar dispozitat përkatëse të ligjit në fuqi.

Shoqëria disponon mjetet e saj financiare. Të gjitha detyrimet e mundshme gjatë veprimtarisë së shoqërisë do të mbulohen nga fondet përkatëse

apo nga fondi rezervë, ose me zmadhimin e kapitalit fillestar. Të gjitha pasuritë e shoqërisë pasqyrohen në bilancin e saj me vleftë të shprehur në monedh shqiptare.

## **NENI 12**

### **Eksperti kontabël i shoqërisë**

Shoqëria fillimisht do të ket një ekspert kontabël, i cili do të emërohet nga ortaku i vetëm për një për një periudh e cila përcaktohet në kontratën e punësimit.

## **KAPITULLI IV**

### **Marrdhëniet e punës në shoqëri**

## **NENI 13**

Marrdhëniet epunës në shoqëri dhe në degët e saj do të rregullohen nga kontrata e punës.

Për çështje të cilat nuk mund të rregullohen nga kontrata do të aplikohen dispozitat e Kodit Shqiptar të Punës.

## **KAPITULLI V**

### **Mbyllja e shoqërisë**

## **NENI 14**

Aktiviteti i shoqërisë është për një periudhë të përcaktuar kohe dhe mund të mbyllet kur:

a) Mbaron afati i parashikuar në aktin e themelimit

b) Nuk mund të realizohet objekti i shoqërisë sipas Aktit të Themelimit të Statutit

c) Një vendim të tillë e merr ortakët i vetëm i shoqërisë

d) Nëse shoqëria nuk rezulton fitimprurëse gjatë dy viteve të fundit

#### **NENI 15**

##### **Likuidimi i shoqërisë**

Likuidimi i shoqërisë do të bëhet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në çastin e likuidimit.

Kur shoqëria kalon në procedurë likuidimi:

Pasuritë që janë në zotërim të shoqërisë me të drejtë përdorimi i kthehen pronarit.

#### **NENI 16**

Në rastet kur aktiviteti i degëve mbyllet për shkak të riorganizimit, afatet e mbylljes vendosen nga ortakët i vetëm të saj.

Mjetet financiare të fituara nga aktiviteti i degëve të likuiduara dhe fondet financiare vihen në dispozicion të shoqërisë duke bërë fillimisht pagesat për likuidimin e kreditorëve.

#### **NENI 17**

##### **Dispozita të fundit**

Ky statut është hartuar në katër kopje me vlerë të barabartë në gjuhën shqipe.

Për rregjistrimin e shoqërisë përdoret një kopje e cila ka përparsi ligjore.

Për sa më sipër unë ortakët i vetëm rash dakord.

**Ortakët  
Apostol Paja**

